



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS  
Stilistikë e Gjuhës B

**Ngarkesa:** 4 kredite, 40 orë mesimore, 20 leksione+20 seminare;

**Viti / Semestri :** Viti II , semestri I

**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme

**Programi i studimit:** “Bachelor në Gjuhë Frënge”

**Kodi i etikës:** Kodi i etikës UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

Kjo lëndë u drejtohet studentëve të vitit të dytë të ciklit të parë me qëllimin që t’i pajisë ata me njohuri themelore të stilistikës dhe t’i familiarizojë me nocionet kryesore të saj, të cilat do t’u vlejnjë më tej në analizat e teksteve të tipologjive të ndryshme. Gjatë orëve praktike do të motivohen punët në grup dhe do të nxitet ndërveprimi mes studentëve. Do të përdoren materiale mbështetëse, të cilat do të plotësojnë nocionet themelore të lëndës, me qëllim që studentët të familjarizohen me shumëllojshmërinë e tematikave të trajtuara. Lënda është e organizuar në leksione dhe seminare.

**Objektivat specifike lëndore:**

Kjo lëndë synon t’i njohë studentët me zhvillimet më të rëndësishme, me konceptet dhe nocionet themelore të stilistikës. Lënda kërkon të zhvillojë te studentët mendimin kritik në lidhje me dukuritë e studiuara stilistikore si dhe t’u japë atyre elemente të analizës stilistikore.

**Rezultatet e të nxënit:**

Në përfundim të modulit, studentët do të fitojnë aftësitë në vijim:

- 1.Njohja e dukurive dhe e koncepteve baze në stilistikë
- 2.Identifikimi dhe shpjegimi teorik i dukurive stilistikore
- 3.Njohja dhe përdorimi i stileve të ndryshëm në përshtatje me kontekstet e ligjërimit.
- 4.Aftësi për të analizuar elementet stilistikore të një teksti apo situatë ligjërimore
- 5.Njohja e vlerës stilistikore, e konotacioneve, e stileve funksionale, etj.
- 6.Aftësi për të përdorur elemente gjuhësore në përputhje me stilin e kërkuar nga konteksti ligjërimit.